



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI TEKNIK I AKCIZËS DHE PROCEDURAVE DOGANORE

Nr. [REDACTED] Prot

Tiranë, më [REDACTED] / [REDACTED] / 2023

Lënda: Kthim përgjigje

**KOMPANISË “BALCIG” SHPK**

Adresa: [REDACTED]

Në vijim të kërkesës tuaj ardhur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me nr.1005 Prot. datë 19.01.2023, me anë të së cilës trajtoni shkallën e taksimit për produktin ‘nikotinë lëng’, bëjmë me dije se:

Në kërkesën tuaj kërkoni sqarime lidhur me nivelin e akcizës për një produkt të cilin ju e emërtoni si “cigare elektronike që janë të parambushura me lëng që përmban nikotinë” dhe “lëng ribushës për cigare elektronike që përmban edhe nikotinë”, produkte për të cilët nuk përcaktoni klasifikimin e kodit tarifor.

Sjellim në vëmendje se operatori ekonomit ka detyrimin e përcaktimit të kodit tarifor të produktit me të cilin operon.

Megjithatë, ju informojmë se, referuar ligjit 61/2012 për ‘Akcizat në RSH’ I ndryshuar, është përcaktuar se “akciza” është një taksë që zbatohet mbi produktet e akcizës, të prodhuara dhe të importuara, që hidhen për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë, konkretisht neni 18 pika 2 ka përcaktuar se, citojmë:

*‘ Akciza llogaritet bazuar në njësitë matëse, sipas seksioneve respektive dhe sipas shtojcës 1 të këtij ligji.’*

Pra përlllogaritja e akcizës për çdo produkt është e përcaktuar në shtojcën Nr. 1 të ligjit.

Lidhur me pretendimin tuaj se ka një frymë të ligjit 'Për Akcizat' se akciza paguhet vetëm për sasinë e nikotinës që përmban lëngu, vlerësojmë të theksojmë faktin se për ato produkte për të cilat baza e taksimit do të aplikohet për njërin nga komponentet e produktit final janë të shprehura specifikisht në shtojcën Nr.1 të ligjit 'Për Akcizat'.

Pra ndodhemi përpara faktit se ligji i ka të specifikuara produktet mbi të cilat akciza do të llogaritet vetëm për njërin nga komponentet e produktit final dhe përcaktimi i këtyre produkteve përjashton produktet e tjera.

Përsa më lart, po sjellim disa shëmbuj të marra nga aneksi nr. 1 të ligjit të akcizës :

- Për produktin 'neskafe' shkalla e taksimit në ligj është për **lekë /kg kafe**
- Për produktin 'Pije alkoolike' shkalla e taksimit ne ligj është për **lekë/ HL alkool anhidër**
- Për produktin 'Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpininën e katranit mineral (masticet bituminoze) Vernik Bituminoz (psh asfalto-beton)' shkalla e taksimit është për **lekë /kg bitum.**

Përsa i takon "produkte që përmbajnë nikotinë lëng", taksimit në ligj është për **leke/ml.**

Gjithashtu bëjmë me dije se produkti "lëng nikotine" është në tregun shqiptar prej vitesh dhe nga të dhënat në sistemin informatik doganor rezulton se nga autoriteti doganor të jetë aplikuar niveli i akcizës i përcaktuar në shtojcën 1 të ligjit "Për Akcizat".

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

ZV. DREJTORI I PËRGJITHSHËM

